

**GJYKATA E QARKUT E GJILANIT**

**KA.nr.1/12**

**Data: 1 mars 2012**

Gjyqtari për konfirmim të Aktakuzës të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Gjyqtari i EULEX-it Cezary Dziurkowski, duke vepruar në lëndën penale kundër:

**I.**

<b>Emri</b>	Begzad
<b>Mbiemri</b>	Sinani
<b>Emri i babës</b>	Qamil
<b>Data e lindjes</b>	10.08.1963
<b>Vendi i lindjes</b>	Fshati Kopernicë, Komuna e Kamenicës
<b>Gjinia</b>	Mashkull
<b>Adresa</b>	Fshati Kopernicë, Komuna e Kamenicës
<b>Kombësia</b>	Shqiptar
<b>Shtetësia</b>	Kosovë
<b>Vendndodhja</b>	
<b>Numri i L.Nj.</b>	1003556405

**II.**

<b>Emri</b>	Hasan
<b>Mbiemri</b>	Keqmezi
<b>Emri i babës</b>	Muharrem
<b>Data e lindjes</b>	20.04.1965
<b>Vendi i lindjes</b>	Fshati Kopernicë, Komuna e Kamenicës
<b>Gjinia</b>	Mashkull
<b>Adresa</b>	Fshati Kopernicë, Komuna e Kamenicës
<b>Kombësia</b>	Shqiptar
<b>Shtetësia</b>	Kosovë
<b>Vendndodhja</b>	
<b>Numri i L.Nj.</b>	

Sepse ekziston dyshimi i bazuar se kanë qenë të përfshirë në kryerjen e veprës penale si në vijim për të cilën janë ndjekur sipas detyrës zyrtare:

**Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit**, në kundërshtim me Nenin 339, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me Nenin 23 të KPK.

Pas seancës për konfirmim të mbajtur me 7 shkurt dhe 1 mars 2012, në praninë e të pandehurve Begzad Sinani dhe Hasan Keqmezi dhe mbrojtësve të tyre, Shemsedin Piraj dhe Visar Musa, dhe Prokurorit Publik Special, Faik Halili sikurse edhe në praninë e përfaqësuesit të palës së dëmtuar Shaip Surdulli Kryetar i Komunës së Kamenicës.

Sipas Nenit 316, par. 4 të KppK,

Merr këtë:

## AKTVENDIM

**1. KONFIRMOHET Aktakuza PP. Nr. 57/2011, të datës 22 dhjetor 2011, e ngritur kundër të pandehurve Begzad Sinani dhe Hasan Keqmezi, për vepër penale-Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit, të kryer në bashkëveprim, në kundërshtim të Nenit 339, par. 1, 2, 3 lidhur me Nenin 23 të KPK.**

**2. Të gjitha provat të referuara në Aktakuzë janë të pranueshme. Të gjitha dokumentet e bashkëngjitura në shkresat e lëndës janë grumbulluar në mënyrë të ligjshme.**

**3. Pasi që Aktakuza bëhet e plotfuqishme, Aktakuza dhe shkresat e lëndës menjëherë duhet të dërgohen Kryetarit të trupit gjykues të kësaj Gjykate për shqyrtim kryesor.**

**4. Kopja e këtij Aktvendimi me arsyetimin do t'ju dorëzohet palëve me postë në ditët në vijim.**

## Arsyetimi

### *1. Konstatimet e seancës për konfirmim të Aktakuzës dhe lejueshmëria e provave*

Me 22 dhjetor 2011 Prokurori Special i PSRK ka ngrit Aktakuzën PPS Nr. 57/11 kundër të pandehurve të sipërpërmendur.

Pas vendimit nga Personi Përgjegjës i Ekipit të Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjilan, të marrë me 16 janar 2011 për caktimin e Gjyqtarit të EULEX-it Cezary Dziurkowski për Gjyqtar për konfirmim të Aktakuzës, është mbajtur seanca për konfirmim para këtij Gjyqtari.

Të gjitha palët i kishin përmbushur obligime lidhur me paraqitjen e provave, siç parashihet me Nenet 307 dhe 308 të KPPK.

Prokurori Special e ka lexuar Aktakuzën dhe kërkoi nga Gjykatën që ta konfirmoj atë në tërësi sepse ka mjaft prova për ta mbështetur dyshimin e bazuar se të pandehurit Begzad Sinani dhe Hasan Keqmezi kanë kryer veprën penale- shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të Nenit 339, par. 1, 2, 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me Nenin 23 të KPK.

Të pandehurit Begzad Sinani dhe Hasan Keqmezi janë në dijeni me përmbajtjen e Aktakuzës dhe u deklaruan të pafajshëm lidhur me pikat e Aktakuzës.

I pandehuri Begzad Sinani deklaroi se nuk e ka kryer veprën penale dhe i kundërshtoi provat e siguruar nga Prokurori i PSRK-së. Për më tepër, i pandehuri deklaroi se gjatë mandatit të tij të gjitha veprimet janë ndërmarra në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

I pandehuri i solli Gjykatës prova tjera duke propozuar të hidhet poshtë Aktakuza. Ai gjithashtu pohoi se ka pas pengesa nga Kryetari aktual Komunes së Kamenicës për të pas qasje në dokumentet publike përmes të cilave ka mundur të vërtetoi pafajin e tij. Megjithatë, kur është pyetur, ai konfirmoi se nuk ka parashtruar asnjë kërkesë me shkrim siç kërkohet me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, por personat përgjegjës nga Arkivi i Komunes së Kamenicës i treguan se at nuk guxojnë t'ia japin dokumentet e kërkuara.

I pandehuri Hasan Keqmezi deklaroi se nuk e ka kryer veprën penale dhe i kundërshtoi provat e siguruar nga Prokurori i PSRK-së. I pandehuri i solli Gjykatës prova tjera për ta vërtetuar pafajin e tij dhe propozoi hedhjen poshtë të Aktakuzës.

Mbrojtësi Shemsedin Piraj kundërshtoi kualifikimin ligjor të veprës penale duke theksuar se dispozitivi jep vetëm përshkrimin e përgjithshëm kinse të dëmit të shkaktuar dhe veprimeve e ndërmarra nga të pandehurit- si pasojë mbrojtësi i propozoi Gjykatës që ta hedh poshtë Aktakuzën.

Mbrojtësi Visar Musa deklaroi se Aktakuza nuk duhet të konfirmohet sepse klienti i tij nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Për atë, lidhur me arsyet e lartpërmendura dhe ekzaminimit të përpiktë të shkresave të lëndës, Gjykata gjeti se provat e propozuara janë të pranueshme sikurse edhe dokumentet tjera të përmbajtura në shkresat e lëndës si dhe janë grumbulluar në mënyrë të ligjshme.

Aktakuza i plotëson të gjitha kriteret parapara me Nenin 305, Paragrafi 1, të KPPK.

## ***2. Dyshimi i bazuar mbi fajësinë lidhur me pikat e akuzës***

Gjyqtari për konfirmim të Aktakuzës është i mendimit se ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit Begzad Sinani dhe Hasan Keqmezi kanë kryer veprën penale siç edhe akuzohen sipas Aktakuzës, dhe të gjitha rrethanat tjera të shënuara në Nenin 316 paragrafët 1 deri 3 të KPPK të cilat do të mundeshin të arsyetojnë hedhjen poshtë të Aktakuzës nuk janë gjetur.

I pandehuri Begzad Sinani, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Kamenicës dhe i pandehuri Hasan Keqmezi, në cilësinë e Menaxherit të Prokurimit Komunën e Kamenicës, kanë ushtruar detyrat specifike zyrtare, siç është përshkruar në Aktakuzë, bazuar në autorizimet e ndërmarra sipas ligjit. Për atë, sipas nenit 107, par. 1, nënpar. 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) të dytë do të konsiderohen se kanë vepruar nga pozitat e personave zyrtar.

Gjyqtari për konfirmim të Aktakuzës i ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës në atë mënyrë që mos ta paragjykojnë përfundimin e shqyrtimit kryesor siç edhe kërkohet me Nenin 317, par. 2 të KPPK.

Bazuar në deklaratat e të pandehurve Begzad Sinani dhe Hasan Keqmezi të dhëna para Prokurorit të PSRK-së sikurse edhe bazuar në prova tjera që gjenden në shkresat e lëndës, japin një pasqyre të gjendjes faktike e cila plotëson kriteret e dyshimit të bazuar ashtu siç kërkohet sipas ligjit.

Si përfundim, të gjitha arsyet tjera të përmendura në Aktakuzë dhe provat e propozuara janë të pranueshme dhe të mjaftueshme për ta mbështetur dyshimin e bazuar se të pandehurit e lartpërmendur kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar sipas Aktakuzës.

Kualifikimi ligjor i sugjeruar nga Prokurori Publik në Aktakuzë është gjithashtu i drejtë, me që vepra penale e përshkruar bie me të drejtë nën përcaktimin dhe dispozitat ligjore të KPPK si është referuar në Aktakuzë.

Bazuar në arsyet e lartpërmendura, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

**GJYKATA E QARKUT E GJILANIT**  
**Me 1 mars 2012**



Gjyqtar për konfirmim të Aktakuzës

Cezary Dziurkowski

Këshillë juridike:

Sipas Nenit 432 dhe Nenit 434 (2) të KPPK ankesa kundër këtij Aktvendimi mund të parashtrohet Trupit gjykues tre-anëtarësh të kësaj Gjykate, brenda (3) ditëve nga data dhe koha e pranimit të tij nga Palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur.